

Data 03.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“BLERJE PAJISJE, MOBILERI PER SHKOLLAT E ARSIMIT BAZE (SHKOLLA 9-VJECARE
”SKENDER LIBOHOVA”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39150000-8 Mobilje dhe pajisje të ndryshme

VLERA E FONDIT LIMIT:

**Fondi limit i përlogaritur: 6.570.494 (gjashte milion e peseqind e shtatedhete mije e
katerqind e nentedhete e kater) leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Qendra e Arsimit, Lushnje**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës Shtojcës3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit shtojcës 8
- c. Formulari ofertes sipas shtojces 1,2

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: - Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga Operatori ekonomik gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2020,2021,2022**) të leshuar nga Administrata Tatimore ku vlera e xhiros duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. *Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohej për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që (nenin 77, pika 3)..”*garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në legjislacionin tatimor ku xhiroja dhe bilancet kanë si afat perfundimtar për tu mbyllur dhe dorëzuar pranë organeve tatimore maksimumi deri në fund të muajit Mars të vitit që vjen, sipas ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe nën 43, pika 2/c të VKM-së Nr. 285 datë 19.5.2021, ku përcaktohet ndër të tjera se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të **tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.**

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". "Nese vlersohet, autoriteti kontraktor mund te kerkoje qe OE te japin informacione ne bilancet e tyre vjetore, per nje periudhe maksimumi tre vitet e fundit financiare, qe te tregojne raportet, ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nese kerkohet nje ose dy bilance, kerkesa konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit."

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, sipas ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 i ndryshuar. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 pranë njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate** (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit.

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per proceduren e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten e vlefshme: ISO 9001 : 2015 (Sistemi i menaxhimit te cilësisë), objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit; ose Ekuivalente (Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 pika 1 "Per prokurimin publik", sipas të cilit: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës 1 shofer dhe 2 punetor krahu. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për 3 (tre) **muajin e fundit** duhet te jetë **3 (tre)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore

2.3.4 Operatori ekonomik prodhues/tregtar duhet të disponojë 1 (nje) mjet transporti me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mobiljesh. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

- **Për mjetet në pronësi**, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (e vlefshme).

-**Për mjetet e marra me qira**, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5 a,c,ç pika 6.b).

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në shkolla.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të leshojë një deklaratë për periudhën 1 vjeçare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë të detyrueshme që mund të kërkohen.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun e** mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara..

Gjithashtu, njësitë e prokurimit bazuar në preventivin e mallrave objekt kontrate që kërkohen të furnizohen, duke qënë se disa prej tyre kanë një vlerë të lartë të kontratës objekt prokurimi dhe referuar funksionit që kanë (ku do të përdoren nga nxënësit dhe mësuesit), duhet të jenë të një cilësie të mirë, dhe të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë të kërkuar, vlerëson se OE duhet të paraqesë **Katalogun e** mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të gurmës së pikës 6 e nenit 40 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike, nëni 40 pika 6 germa b- fotografite apo kataloget teknike

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

- **Preventivi per realizimin e objektit te prokurimit i hartuar nga inxhinieret eshte si me poshte:**

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasi
1	TAVOLINA NXENESISH	cope	350
2	KARRIGE NXENESISH	cope	700
3	TAVOLINA MESUESI	cope	17
4	KARRIGE PER MESUES	cope	95
5	DOLLAP PER KLASA	cope	24
6	DERRAS E ZEZE	cope	20
7	DOLLAP PER KABINETIN E KIMIS DHE BIOLOGJISE	cope	1
8	DOLLAP PER KABINETIN E FIZIKES	cope	1
9	DOLLAP PER REGJSTRA	cope	1
10	TAVOLINA PER MESUES PER KABINETIN E INFORMATIKE	cope	2
11	TAVOLINA NXENESISH 2 VENDESHE	cope	12
12	KARRIGE PER NXENES NE KABINETIN E INFORMATIKE	cope	30
13	TAVOLINA PER BIBLIOTEK	cope	3
14	RAFTE BIBLIOTEKE	Cope	4
15	TAVOLIN DREJTUESISH FORM L (E VOGEL)	cope	3
16	TAVOLIN MBLEDHJE E MADHE	cope	3
17	DOLLAP GARDEROBE	cope	5
18	DOLLAP PER ARKIVIN	cope	2
19	RAFT PER INFIERMJERIN	cope	1

Afatet e levrimit: Afati kohor për levrimin e mallrave, do të jetë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës 30 dite kalendarike..

Vendi ku do te levrohen mallrat do te jete ne ambjentet e Shkolles”Skender Libohova ”Lushnje.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT: